

THE SIGRID RAUSING TRUST

THIRRJE PËR APLIKIM NË KUADËR TË FONDIT TË GRAVE TË KOSOVËS

Publikuar më: 13 qershor 2024

Afati i fundit për aplikim: 7 korrik 2024

PASQYRË E PROGRAMIT

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka kënaqësinë të publikojë raundin e njëzetë të granteve në kuadër të Fondit të Grave të Kosovës (FGK). Ne ftojmë organizatat anëtare të angazhuara **për të avancuar të drejtat e grave dhe barazinë gjinore** që të paraqesin aplikacione për mbështetje organizative për organizatat e tyre.

Më konkretisht, aplikacionet duhet **të tregojnë në mënyrë të qartë se si granti i tyre do të** kontribuojë në realizimin e Objektivave Strategjike të identifikuar nga anëtarët e RrGK-së në Strategjinë e RrGK për 2023-2026, drejt **mbështetjes, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe interesave të grave dhe vajzave**; drejt një qasjeje të bazuar në të drejtat; dhe drejt mbështetjes së ndryshimeve më të qëndrueshme

RrGK inkurajon fuqishëm **iniciativat me ndikim** që rrisin ndërgjegjësimin e publikut për çështjet kyçe që kanë të bëjnë me avancimin e barazisë gjinore, transformojnë normat gjinore dhe shfaqin punën dhe arritjet e aktivisteve për barazi gjinore dhe të të drejtat e grave në Kosovë. Strategjitë efektive mund të përfshijnë metoda të ndryshme komunikimi si fushatat e mediave sociale, teatri i forumit dhe partneritetet me organet e medias për të siguruar një shtrirje të gjerë. Përpjekjet e avokimit duhet të angazhojnë palët e interesuara, të ndikojnë në politika dhe të angazhojnë gra dhe burra të ndryshëm drejt arritjes së **ndikimit** të qëndrueshëm.

Shpenzimet e papranueshme

Duke pasur parasysh kërkesat nga donatorët e RrGK-së, mbështetja organizative nuk duhet të përdoret për blerjen e pronës, tokave ose ndërtesave. Blerja e pajisjeve mund të bëhet vetëm me aprovim nga RrGK dhe me kusht që ky të mos jetë qëllimi kryesor i aktiviteteve që ju parashihni në aplikacion. Në këtë rast mënyra se si pajisjet do të përdoren dhe asgjësohen pas përfundimit të kontratës duhet të dokumentohet. Granti nuk mund të përdoret për: borxhet dhe tarifat e lidhura me shërbim; provizionet për humbjet; detyrimet e mundshme në të ardhmen; provizionet; kostot e udhëtimit për biletat të aeroplanit të klasit të biznesit ose klasit të parë; kreditë për palët e treta; mëditje shtesë, të tilla si mëditje për pjesëmarrje në takime apo mëditjet për stafin pjesëmarrës/folësit në punëtori; dhe për pjesëmarrje ose mbështetjen e partive, grupeve, lëvizjeve ose fushatave politike.

Zbatuar nga:



NDARJA E GRANTEVE

Grantet që pritet të ndahen do të mbështeten nga Sigrid Rausing Trust, në shumën e përgjithshme prej 50,000€.

MADHËSIA DHE KOHËZGJATJA E GRANTEVE

RrGK parasheh të ndajë rreth pesë (5) grante me shumë maksimale prej 10,000€ për secilin. Iniciativat pritet të fillojnë rreth datës 15 gusht 2024 dhe të zgjasin deri në gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

RrGK rezervon të drejtën për të financuar çdo ose asnjë prej aplikacioneve të dorëzuara, si dhe për të diskutuar për aplikacionet me aplikuesit. Vendimet për financimin do të merren nga Komisioni për Vlerësimin e Granteve të FGK-së (KVG).

KUALIFIKUESHMËRIA

Për të aplikuar, organizatat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë anëtare të RrGK-së;
2. Të jenë të fokusuara në fuqizimin e grave dhe/ose avancimin e barazisë gjinore;
3. Të mos kenë anëtarë të stafit që janë aktualisht pjesë të Bordit të RrGK-së, apo pjesë e KVG-së.
4. Të mos kenë në vazhdim ndonjë grant të mbështetjes organizative.

KVG do t'i japë përparësi financimit për organizatat që:

- kanë një strategji të artikuluar qartë ose synime strategjike si organizatë, për të fuqizuar gratë dhe/ose për të avancuar barazinë gjinore në Kosovë. Nëse nuk ekziston një strategji e shkruar, një përshkrim i shkurtër i qëllimeve strategjike mund të dorëzohet bashkë me formularin e aplikimit;
- synojnë të sjellin ndryshime të qëndrueshme në mbështetjen, mbrojtjen ose promovimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në nivel komunal dhe/ose kombëtar (p.sh., organizatat që synojnë të kontribuojnë në rezultate të prekshme dhe të dukshme si legjislacioni i ri, përmirësimi i shërbimeve shtetërore për gratë, buxhetet komunale më të përgjegjshme ndaj nevojave të ndryshme të grave, etj.);
- kanë qëllime strategjike që do të kontribuojnë në zbatimin e Strategjisë së RrGK-së për 2023-2026, të krijuar dhe të rënë dakord nga anëtarët e RrGK-së për të adresuar së bashku pabarazitë kryesore gjinore që ato kanë identifikuar në Kosovë;
- shpjegojnë mirë në aplikimin e tyre se si mbështetja organizative do t'u mundësojë atyre të arrijnë qëllimet strategjike të organizatës së tyre;
- kanë një anëtarësim dhe/ose grupe të synuara/përfituesit të qarta të cilave organizata u shërben;
- raportojnë rregullisht te grupet e synuara/përfituesit, anëtarësimi dhe/ose bordi për progresin drejt realizimit të qëllimeve të tyre strategjike, sipas nevojë e në përputhje me statutin e organizatës;
- synojnë në mënyrë aktive të jenë gjithëpërfshirës të grave dhe vajzave të ndryshme, duke mbështetur dhe/ose angazhuar persona me aftësi të ndryshme, grupet etnike të pakicave, gratë nga zonat rurale, të rinjtë dhe/ose personat e marginalizuar në punën e tyre;
- sigurojnë një buxheti organizativ të plotë dhe të shqyrtuar mirë për vitet 2024 dhe 2025, bazuar në financimet aktualisht të siguruara dhe të kërkuara; aplikacioni duhet të shpjegojë qartë se si shfrytëzimi i fondeve do të mbështesë buxhetin e përgjithshëm të organizatës [shënim: buxheti organizativ është një buxhet që përfshin të gjitha shpenzimet ekzistuese dhe të parashikuara të organizatës për të gjithë stafin e saj, operacionet dhe aktivitetet e planifikuara për këtë periudhë, për të arritur qëllimet strategjike të saj. Në mënyrë

ideale, buxheti duhet të përfshijë kolona që tregojnë fondet që organizata po merr, planifikon të marrë dhe ende duhet të sigurojë që të ketë burimet që i nevojiten për të realizuar synimet e saj për atë vit. RrGK do të mbështesë anëtarët në përgatitjen e këtij dokumenti, sipas kërkesës;

- demonstrojnë se si monitorojnë dhe vlerësojnë punën e tyre dhe si planifikojnë ta bëjnë këtë në të ardhmen; dhe
- demonstrojnë përvojën e zbatimit të suksesshëm të granteve të dhëna nga FGK më parë.

PROCEDURAT PËR DORËZIMIN E APLIKACIONIT

Aplikacionet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Aplikacioni i plotë duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike në e-mail adresën: grants@womensnetwork.org. Aplikuesit duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

1. **Aplikacionin**, duke përdorur formën e aplikimit të RrGK-së (në formatin Word, të bashkëngjitur e që mund ta gjeni në: www.womensnetwork.org);
2. **Strategjinë e organizatës**, nëse është në formën e shkruar, ose një përshkrim të shkurtër të qëllimeve strategjike të organizatës;
3. **Statutin**; dhe
4. **Buxhetin e përgjithshëm organizativ për vitin 2024**, duke përdorur formën e RrGK-së (formatin Excel, ose formatin e organizatës tuaj, të bashkëngjitur e që mund ta gjeni në: www.womensnetwork.org).

Propozimet e paraqitura tek RrGK-ja duhet të jenë origjinale dhe t'i përkasin vetëm organizatës aplikuese. Plagjiatura do të rezultojë në diskualifikimin nga procesi i vlerësimit.

RrGK do t'i mbajë të gjitha materialet dhe dokumentet e dorëzuara nga aplikuesit. RrGK nuk do të përdorë informacionin e paraqitur nga aplikuesit për qëllime të tjera përveç rishikimit dhe nuk do t'i japë këtë informacion personave ose institucioneve të tjera, përveç në rastet kur kërkohet nga ligji i Kosovës ose nga donatorët.

Pas dorëzimit të aplikacionit, aplikuesit do të marrin një konfirmim për pranimin me numër aplikimi, të nënshkruar nga stafi i RrGK-së.